



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONI I ANKIMIMEVE DHE SANKSIONEVE

Data: 02.08.2024

Nr: 15

Ora: 22:15

SHKURTIM-VENDIMI

PËR

**SHQYRTIMIN E KËRKESËS ANKIMORE NR. 8, DEPOZITUAR NGA Z. ARQILEA BOLLANO, KRYETAR I
KOMANDUAR, BASHKIA HIMARË**

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 02.08.2024, me pjesëmarrjen e:

Elvis	ÇEFA	-	Relator
Elvin	LAKO	-	Anëtar
Ilirjan	RUSMALI	-	Anëtar
Ledio	BRAHO	-	Anëtar

Shqyrtoi çështjen me:

ANKUES: Arqilea Bollano, kryetar i komanduar, bashkia Himarë

PALË E INTERESUAR: Koalicioni “Bashkë Fitojmë”, përfaqësuar nga z. Ivi Kaso

OBJEKT: Kundërshtim i vendimit nr. 159, datë 01.08.2024 “Për dhënie autorizimi për ndërrimin e vendndodhjes së QV nr. 4589/00, për zgjedhjet e pjesshme për kryetar të bashkisë Himarë, të datës 4 gusht 2024”, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.

BAZË LIGJORE: Nenet 21, 123/1, 124/1, të “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe pika 8, e nenit 9, të vendimit të Komisionit Rregullator nr. 03, datë 06.11.2020 “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve”.

Data: 02.08.2024 Nr: 15
Ora: 22:15



“Për shqyrtimin e kërkesës ankimore nr. 8, depozituar nga z. Arqilea Bollano, kryetar i komanduar, bashkia Himarë”

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në përfundim të shqyrtimit administrativ të kërkesës ankimore nr. 8, datë 02.08.2024 depozituar nga z. Arqilea Bollano, kryetar i komanduar, bashkia Himarë, bazuar në analizën e fakteve dhe provave të administruara, mbështetur në nenin 21, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar,

V E N D O S I:

1. Pranimin e pjesshëm të kërkesës ankimore nr. 8, datë 02.08.2024 të kryetarit në detyrë të bashkisë Himarë.
2. Ndryshimin e Vendimit nr. 159, datë 01.8.2024 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve si më poshtë:
 - Bazuar në pikën 11 të nenit 62 të Kodit Zgjedhor, ndryshimin e vendndodhjes së QV nr. 4589/00, nga shkolla 9-vjeçare “Nikolla Pano Meniko”, Spile, Rr. Xhorxh Tened, nr. 4 në ambientin privat ne pronësi te shtetasit Odhise Milo me adrese Himarë, Lagjia 1 Maji, Rr. Milto Kallushi.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve dhe KZAZ nr. 88, bashkia Himarë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës Administrative të Apelit, brenda afatit ligjor.

U shpall në Tiranë, sot me datë 02.08.2024.

Elvis	ÇEFA	-	Relator
Elvin	LAKO	-	Anëtar
Ilirjan	RUSMALI	-	Anëtar (Kundër)
Ledio	BRAHO	-	Anëtar